

Raporti i Qeverisë së SHBA-ve për respektimin e të drejtave të njeriut në botë për vitin 2005, pjesa për Kosovën:

KOSOVË

Kosova ka një popullatë prej rreth 2.2 milion banorëve dhe administrohet prej Misionit të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) duke marrë për bazë Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244. UNMIK-u shpërndan rregulloret të cilat çirren me përgjegjësitë civile dhe legale të etniteteve qeveritare dhe të individëve dhe ligjet e ratifikuara aprovohen nga Kuvendi i Kosovës.

UNMIK-u ka shpërndarë Kornizën Kushtetuese për Qeverinë e Përkohshme në Kosovë (Korniza Kushtetuese) e cila definon institucionet e përkohshme të vetë qeverisjes. Zgjedhjet shumë partiake në Tetor 2004 për vendet në kuvend ishin të lira dhe të ndershme. Autoritetet civile ndërkombëtare të UNMIK-ut dhe organizata e aleancës veriatlantike e forcave paqeruajtëse e autorizuar prej KB për Kosovën ka mirëmbajtur një kontrollë efektive me forcat e sigurimit; megjithatë ka pasur raporte që elementet vendore të forcave të sigurimit kanë vepruar të pavarura prej autoritetit të tyre respektiv.

UNMIK-u dhe IPVQ-të në përgjithësi ka respektuar të drejtat e qytetarëve, megjithatë ka pasur probleme serioze në disa fusha, sidomos ato që kanë të bëjnë me minoritetet. Problemet në fushën e të drejtave të njeriut në vijim janë raportuar:

- Vrasjet me motive politike dhe etnike
- Vdekjet dhe lëndimet prej mjeteve shpërthyes dhe fushave të minuara
- Paraburgimet e tejzgjatura dhe mungesa të proceseve gjyqësore
- Korrupsioni dhe interferenca qeveritare në sistemin gjyqësor
- Sulmet dhe abuzimet kundër gazetarëve
- Antipatia shoqërore kundër Serbëve dhe Kishës Ortodokse Serbe.
- Restriksionet në lirinë e lëvizjes për minoritetet, sidomos për serbët
- Mungesa e progresit për kthimin e personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre
- Një perceptim gjithëpërfshirës i korrupsionit në IPVQ
- Dhuna dhe diskriminimi kundër gruas
- Trafikimi i personave, sidomos vajzave dhe grave për eksploatim seksual
- Dhuna në shoqëri, abuzimet dhe diskriminimi kundër komuniteteve minoritare
- Diskriminimi shoqëror kundër personave me aftësi të kufizuara.
- Puna e fëmijëve në sektorin joformal

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Pjesa e 1-rë Respektimi i integritetit të personit

a.Vrasjet arbitrare dhe jo ligjore

Nuk ka pasur raporte që UNMIK-u, IPVQ, KFOR ose agjentët e tyre kanë kryer vrasje jo-ligjore ose arbitrare.

Gjatë vitit mjetet shpërthyesë prej konfliktit të 1999-ës ose fushat e minuara kanë mbytur dy fëmijë dhe kanë lënduar seriozisht tre, krahasuar me një fatalitet dhe 13 lëndime serioze në 2004. Mjetet shpërthyesë mbetin ende rrezik për civilët.

Një vrasje e nxitur politike ka rezultuar në vdekjen e një polici. Më 13 Janar, persona të panjohura kanë vendosur një bombë nën veturën zyrtare të UNMIK-ut, duke mbytur policin Omar Ali.

Me 7 prill, autoritetet kanë dënuar Shkumbin Mehmetin, Florim Ejupin, Xhavit Kosumin, dhe Faik Shaqirin për vrasjen e një zyrtari të Shërbimit Policor të Kosovës dhe policit të UNMIK-ut në komunën e Podujevës pas demonstratave të Marsit 2004. Të gjithë u mbajtën në paraburgim duke e pritur gjyqin në fund të vitit.

Ka pasur vrasje politike evidente të shqiptarëve etnik. Më 31 janar, persona të panjohur gjuajtën dhe mbytën Sadik Musaj, dëshmitarë në gjykimin “Grupi i Dukagjinit”. Më 6 prill, persona të panjohur kanë mbytur Muhamet Sallaj, një ish-anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më 15 prill, persona të panjohur mbytën Enver Haradinaj, vëllain e kryeministrit dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës Ramush Haradinaj; më 25 qershor, Tasim Osaja, i dyshuar për vrasjen iu dorëzua policisë si përgjigje kundër fletarrestit të lëshuar për të. Më 4 qershor, persona të panjohur nga vetura plagosën gazetarin Bardil Ajeti të së përditshmes shqiptare “Bota Sot” Ajeti vdiq 20 ditë pas lëndimit. Me një gjuajtje tjetër nga vetura persona të panjohur mbytën Muhamet Xhemajili, ish-komandant i UQMB-së grup i shqiptarëve etnik aktiv në komunën e Preshevës në Serbi. Më 5 shtator, një eksplozim në veturë mbyti ish-anëtarin e UCK-së dhe pjesëtarin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, Naser Ramaj dhe vëllain e tij, Jetonin. Më 10 dhjetor, persona të panjohur plagosën dhe mbytën Hasan Rustemin, një dëshmitarë në rastin e pazgjidhur të gjyqit për krime lufte të ish-komandantit të UCK-se (Trupat Mbrojtëse të Kosovës) Selim Krasniqi.

Ka pasur vrasje të motivuara politike dhe etnike të serbëve përgjatë vitit. Më 28 gusht, persona të panjohur plagosën dhe mbytën Ivan Dejanovic dhe Aleksandër Stankovic, dhe plagosën dy pasagjerë në veturën e tyre në një komunë me shumicë Serbe në komunën e Shtërpçës.

Në një sulm me motiv të mundshëm politik më 11 tetor persona të panjohur mbytën turkun Ibish Cakaj, një anëtarë i Partisë Demokratike Turke të Kosovës.

Më 18 maj, një panel ndërkombëtar i gjyqtarëve ka dënuar 6 shqiptarë etnik në lidhje me vrasjen e dy serbëve gjatë trazirave të Marsit 2004: Nexhat Ramadani u dënua me 16 vjet, Xheladin Salihu me 11 vjet, Shaip Ibrahimimi me 3 e gjysmë, Agron Ibrahimimi, Agim Abdullahu dhe Sadri Shabani u dënuan secili me 2 vjet e gjysmë burgim.

Gjatë vitit gjyqi liroi nga aktakuza shqiptarin Labinot Gashi, i cili ishte arrestuar nga policia e SHPK-së për vrasjen e 14 qershorit të serbit Dimitrije Popovic dhe lëndimit serioz të adoleshentit tjetër serb në një gjuajtje nga vetura. Gjykimi i të akuzuarit të dytë shqiptarë, është ende duke u zhvilluar deri në fund të vitit.

Nuk ka pasur zhvillime në vrasjet e marsit në vitin 2004 ku është vrarë babai i Avni Elezaj, një ish-luftëtarë i UCK-së dhe rojë i ish-kryeministrit dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës Ramush Haradinaj.

Nuk ka pasur zhvillime në rastet në vijim të 2003-ës: mbytja e dy dëshmitarëve në rastin e grupit të Dukagjinit, Tahir Zemaj dhe Ilir Selimaj; vrasja me snajperë e policit Satish Menon; dhe vrasjet e ndara të zyrtarëve të SHPK-së Hajdar Ahmeti dhe Agim Makolli. Bedri Krasniqi është një ndër të dyshuarit kryesorë për vrasjet e 2003-ës të anëtarëve të SHPK-së Sebahate Tolaj dhe Isuf Haklaj.

Më 7 prill, autoritetet akuzuan Florim Ejupi me akuzat se ai dhe bashkëpunëtorët e tij planifikuan dhe implementuan bombardimin e autobusit në vitin 2004 afër Podujevës ku u mbytën 11 serbë dhe u plagosën 40. Një aktakuzë e dytë më 7 prill akuzoi Ejupin, Shkumbin Mehmetin dhe Faik Shaqirin në përfshirje në sulmet e marsit 2004 në kontrollën policore ndërkombëtare dhe të SHPK-së të vënë pas trazirave të marsit 2004.

b. Zhdukjet

Nuk ka raporte rreth zhdukjeve të motivuara politikisht; megjithatë ka më shumë se 2000 persona të zhdukur nga konflikti i vitit 1999 të cilët ende nuk u janë gjetur trupat ose nuk janë gjetur.

Një grup punues në Prishtinë dhe zyrtarët e Beogradit për personat e zhdukur prej konfliktit të 1999-ës janë takuar pesë herë përgjatë vitit nën përkrahjen e Këshillit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Gjatë vitit grupi raportoi për 560 trupa të pajetë dhe 57 persona të gjetur të cilët nuk ishin në listën e të zhdukurve. Duke u bazuar në KNKK (Këshilli Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq) 2,464 persona ishin të pagjetur prej dhjetorit krahasuar me më shumë se 3 mijë në fillim të vitit. Prej atyre, KNKK raportoi se 75% ishin shqiptarë etnik, 17% serbë, 4% ishin prej komunitetit romë, ashkali dhe egjiptianë, dhe 3% ishin prej grupeve të tjera etnike.

Gjatë vitit zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur vazhdoi të identifikoj trupat e pajetë të personave të zhdukur në Kosovë. Prej themelimit në 2002 e deri në fund të dhjetorit, zyra ka kryer 446 operacione në teren. Shumë trupa të personave të zhdukur janë gjetur dhe përqendrimi ka qenë në gjetjen e identitetit të 1,389 trupave të pajetë të zbuluar dhe pranuar që nga viti 2002. Prej tetorit zyra për persona të zhdukur ka dorëzuar 2,655 mostra të eshtrave për testim të AND-së në Komisionin Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, dhe ka kthyer 1,484 rezultate.

Në prill Zyra për Persona të zhdukur dhe Forenzikë ka bërë hapjen e shpellës në rrethinën e komunës së Klinës e cila është shfrytëzuar për gjuajtjen e 21 trupave të pajetë.

UNMIK-u vazhdoi të inkurajojë qeverinë serbe për të shpejtuar transferimin e trupave të pajetë të viktimave Kosovare të luftës së 1999-ës të gjetura në varre masive në Serbi, megjithatë progresi ishte i ngadalshëm. Zyra për persona të zhdukur dhe forenzikë ka pranuar 638 trupa , shumica e të cilëve iu kthyen familjeve për rivarrim. Familjet e personave të zhdukur vazhduan të kërkojnë nga qeveria Serbe të kthejë të gjithë trupat e pajetë që ende gjenden në Serbi dhe të ofrojë qasje në shënimet e qeverisë të cilat mund të qojnë deri te lokacionet e varrezave masive të reja ku trupat e pajetë të kosovarëve janë shkatërruar.

Në 2004 zyrat e prokurorit në Prizren shpallën fletë arrestet për dy ish-polic serbë, Goran Janjusevic dhe Slavisa Milkovic, për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullatës civile në regjionin e Prizrenit, duke përfshirë kidnapimin dhe vrasjen e Ardian Zyrtagjiu gjatë konfliktit të 1999 –ës. Të dyshuarit mbeten të lirë deri në fund të vitit.

c. Tortura, Trajtimet e vrazhda, johumane dhe degraduese ose Dënimet

Korniza kushtetuese dhe kodi i procedurave kriminale ndalojnë praktika të tilla, dhe nuk ka pasur raporte që UNMIK-u ose KFOR-i i ka punësuar personat e tillë.

Në qershor anëtarët e lëvizjes së Albin Kurtit “Vetëvendosja” filluan shkruarjen dhe ngjyrosjen e sloganit të tyre “Jo negociata, vetëvendosje” në ndërtesa dhe prona tjera, duke i rritur aktivitetet e tyre gjatë vitit.

Më 19 tetor, SHPK-ja arrestoi dhe abuzoi protestuesit, të cilët e shkruan sloganin në veturat e KB, duke vazhduar me një demonstratë në Prishtinë të organizuar prej anëtarëve të lëvizjes. Në një letër të 25 Tetorit drejtuar përfaqësuesit special të KB-së lidhur me incidentin, Avokati i Popullit Marek Novicki citoi raportet e dëshmitarëve të ngjarjes që “shumë” aktivistë kanë përjetuar “trajtime të rënda” gjatë arrestimit të tyre dhe deklaratat prej personave të cilët janë arrestuar thonë se keqtrajtimi ka vazhduar pasi që janë marrë në paraburgim. Një hulumtim i SHPK-së është duke vazhduar deri në fund të vitit që shkoi.

Disa individë akuzuan KFOR-in për forca të tepruara gjatë kontrollove. Më 18 shtator, policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja me përkrahjen e KFOR-it kontrollon një shtëpi private dhe arrestoi katër serbë në Gracanicë të dyshuar në pjesëmarrje të një numri të vrasjeve në komunën e Lipjanit në vitin 1999. Familja raportoi shtyrjet dhe tërheqjet e anëtarëve prej ushtarëve të KFOR-it dhe zyrtarëve të SHPK-së të cilët e bënë kontrollin; rasti iu dorëzua prokurorit ndërkombëtar dhe hetimet janë në vazhdim.

Më 22 gusht, prokurori publik ndërkombëtar refuzoi që të lirohet komandanti i TMK-së Selim Krasniqi, nën arrest me katër oficerë të tjerë të dyshuar për involvim në abuzimet e personave në vitin 1998 në Drenovc në kampin e paraburgimit. Më 22 gusht, gjyqi liroi njërin prej pesë oficerëve, Milaim Latifi i cili u kthye në TMK.

Ka pasur raporte të sulmeve dhe kërcënimeve kundër personaliteteve shqiptare politike dhe institucionale si dhe kundër individëve. Me 15 mars, persona të panjohur detonuan një eksploziv afër konvojit të presidentit Ibrahim Rugova, duke shkaktuar lëndime kalimtarëve të rastit. Me 18 prill, persona të panjohur vendosën eksploziv në zyret kryesore të partisë politike opozitare Ora, duke shkaktuar lëndimin e disa personave në apartamentet mbi zyrë. Motivet jopolitike, duke përfshirë rivalitetin në mes të klaneve dhe krimet e zakonshme u dyshuan në disa raste.

Ka pasur raportime të dhunës politike kundër serbëve etnik gjatë vitit. Me 8 shkurt, persona të panjohur kanë shkatërruar veturën zyrtare të liderit serb me eksploziv, por nuk shkaktuan viktima. Me 4 korrik, persona të panjohur hudhën një granatë dore në zyret e Partisë Demokratike Serbe në Zubin Potok për “Kosovë dhe Metohi”.

Gjatë vitit autoritetet kanë sjellur një numër të personave në gjyq për krimet lidhur me trazirat ndëretnike në mars 2004. (shih pjesën e 5-të)

Burgjet dhe Kushtet e Qendrave të Paraburgimit

Burgjet dhe qendrat e paraburgimit në përgjithësi i përmbushin standardet ndërkombëtare, dhe UNMIK-u i lejon vizitat nga vëzhguesit e pavarur të të drejtave të njeriut; megjithatë një organizatë joqeveritare vendore “Këshilli i Lirive për Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut (KLMDNJ) ka deklaruar se UNMIK-u ka ndaluar atë në vizitimin e të burgosurve prej majit.

Objektet ishin kohë pas kohe të stërmbushura; megjithatë, ndërtimi i dy objekteve të reja vazhdoi gjatë vitit. Policët e qendrave korrektive të UNMIK-ut kanë udhëhequr burgjet dhe qendrat e paraburgimit por në mënyrë të vazhdueshme kanë transferuar përgjegjësitë Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ka burgje në Lipjan dhe Dubravë si dhe pesë qendra paraburgimi në operim gjatë vitit. KLMDNJ raportoi të ketë marrë rreth 10 thirrjeve telefonike në ditë prej të burgosurve dhe familjeve të tyre duke i akuzuar për abuzim dhe izolim të plotë në burg. Derisa gratë dhe të miturit duhet të mbahen të ndarë nga meshkujt, KLMDNJ deklaroi se ka pasur raste të grave dhe të miturve në Lipjan që janë mbajtur afër meshkujve që kanë mbajtur burgimin për krime më të vogla.

Në dhjetor OSBE-ja konkludoi në mungesë të pastërtisë në qelitë por vërejti përmirësim të kushteve prej 2002 pasi që UNMIK-u dhe SHPK-ja bëri renovimin e qelive ekzistuese dhe ndërtimin e qelive të reja në stacionet policore.

UNMIK-u raportoi 35 procedura disiplinore të cilat u sollën kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës të cilat rezultuan në 11 largim nga puna, 1 suspendim, 20 vërejtje me shkrim, 12 vërejtje me gojë dhe 1 suspendim të promovimit.

Nuk ka raporte që grupet monitoruese ndërkombëtare kanë vizituar burgjet dhe qendrat e paraburgimit në Kosovë gjatë vitit.

d. Arrestimet Arbitrare dhe Paraburgimet

Korniza kushtetuese dhe kodi i procedurave kriminale ndalojnë arrestimet arbitrare dhe paraburgimet, dhe UNMIK-u, KFOR-I dhe IPVQ në përgjithësi vëzhgojnë këto ndalesa në praktikë.

Roli i policisë dhe mjetet e sigurisë

UNMIK-u vazhdoi të transferojë autoritetin dhe funksionet policore SHPK-së, duke i mbikëqyrur. Një komisionier ndërkombëtar i policisë drejtoi policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-së. Forca e kombinuar në përgjithësi ishte efektive dhe qoi deri te një përmirësim përgjatë viteve të kaluara. Anëtarët e minoriteteve etnike bëjnë rreth 16 përqind të SHPK-së, 6900 oficerë në fund viti duke i krahasuar me 15% në 2004.

Grupi Ndërkombëtar për Kriza raportoi se korrupsioni është njëri prej problemeve në forcat e sigurisë e sidomos në policinë kufitare të SHPK-së.

Zyra e jashtme e UNMIK-ut hetoi korrupsionin në UNMIK dhe në sistemin e drejtësisë kriminale. Sistemi i drejtësisë në mënyrë efektive ka dënuar anëtarët e forcave të sigurisë të cilën keqtrajtoi. Njësitë e standardeve profesionale e SHPK-së, e udhëhequr nga policia e UNMIK-ut, kreu më shumë se 200 hetime disiplinore kundër oficerëve të SHPK-së për pjesëmarrje ose për dështim në parandalim të dhunës në trazirat e marsit 2004; shumica e hetimeve janë ende duke vazhduar.

Prej nëntorit, 426 persona janë dënuar me vepra kriminale të ndërlidhura me trazirat e marsit 2004, gjyqi ka dënuar 209 dhe ka liruar 12. Ka pasur 110 raste që kanë vazhduar dhe janë hedhur poshtë akuzat për 95 raste. Në dhjetor një raport i OSBE-së ka akuzuar gjykatat për dënime dhe sjellje jo adekuate të vendimeve si dhe për shfrytëzim të papërshtatshëm të lirimimit me kusht të cilat as nuk janë të lejuara e as të rregulluara me ligj. Aftësia e autoriteteve për të zhvilluar hetime të krimeve në trazira u vështirësua për shkak të largimit të palëve të dëmtuara nga Kosova, humbja e dëshmitarëve, dhe kërcënimet ndaj dëshmitarëve dhe mungesës së vullnetit për të dëshmuar.

Arrestimi dhe Paraburgimi

Policia në përgjithësi ka arrestuar të dyshuarit në mënyrë të hapur duke shfrytëzuar fletëarrestet të lëshuara nga gjykatësi ose prokurori; megjithatë në disa raste të sigurisë së lartë të dyshuarit janë arrestuar në mënyrë sekrete prej policëve nën detyrë ose të maskuar. Me ligj, arrestimet duhet të bazohen në urdhër të prokurorëve dhe të arrestuarit duhet të sillen para gjyqtarit brenda 72 orëve; megjithatë ka raporte që policia e UNMIK-ut e ka keqpërdorur autoritetin duke arrestuar persona sidomos me dënime të vogla janë mbajtur për më pak se 72 orë pa qëllim të ngritjes së aktakuzës dhe me më shumë se 72 orë pa ngritur një aktakuzë formale. Të dyshuarit kanë të drejtën të informohen për arsyet e arrestimit të tyre në gjuhën të cilën e kuptojnë; të mos flasin dhe të mos i përgjigjen pyetjeve përveç atyre që kanë të bëjnë me identitetin; për asistencë pa pagesë për përkthyes; të kenë një këshilltarë mbrojtës ose të iu sigurohet një nëse nuk mund të paguajnë asistencën legale; për tretman mjekësor duke përfshirë tretmanin psikiatrik; dhe të lajmërojnë anëtarët e familjes. Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja në përgjithësi i kanë respektuar këto të drejta në praktikë. Ligji lejon kaucionin për lirim nga paraburgimi, por kjo aplikohet vetëm në disa raste .

KFOR-i mund të arrestojë dhe të mbajë të mbyllur individët pa fletëarrest, dhe komandanti i KFOR-it mund të zgjasë paraburgimin e individëve në shtesa prej 30 ditësh pa i akuzuar ata për krim para gjyqit, nëse nuk lirohen prej gjyqit. Nuk ka raporte rreth arrestimit të personave nga KFOR-i pa fletëarreste gjatë vitit.

Nuk ka raporte që KFOR-i, UNMIK-u ose SHPK-ja ka mbajtur të burgosur politikë gjatë vitit.

Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja mund të mbajë individë në paraburgim për një periudhë maksimale prej 30 ditësh. Ligji lejon arrestin shtëpiak, kërkesën për paraburgim, një shfrytëzim të zgjeruar të lirimimit me kusht si alternativa për paraburgim. Ishin rreth 700 deri në 800 të arrestuar, dhe rreth 2,200 persona u paraburgosën gjatë vitit.

e. Mohimi i gjykimeve të ndershme publike

Korniza kushtetuese ofron një sistem gjyqësor të pavarur, megjithatë sistemi gjyqësor vendor ishte ndonjëherë i njëanshëm dhe ka pasur ndikim nga jashtë sidomos në rastet ndëretnike, dhe nuk qonte deri në zgjidhje dhe përfundim të procesit.

Ka pasur raporte të besueshme për korrupsion në gjyqësinë vendore dhe Gjyqi Suprem dhe gjyqet tjera kanë shtyer rastet për më vonë duke ia drejtuar qeverisë në disa raste.

Autoriteti legal është në kompetencat e UNMIK-ut nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit. Autoritetet police dhe të drejtësisë të UNMIK-ut kanë përgjegjësinë kyçe për sistemin gjyqësor por punon me gjyqtarët dhe prokurorët vendor. Qeveria serbe operon një sistem gjyqësor paralel në enklavat etnike serbe.

Sistemi gjyqësor ka një Gjykatë supreme, 5 Gjykata Regjionale, 25 Gjykata Komunale dhe një Gjykatë Ekonomike. Më 27 dhjetor, numri i gjykatësve ndërkombëtarë të caktuar prej UNMIK-ut është zvogëluar prej 18 në 14 dhe numri i prokurorëve ndërkombëtar prej 8 deri në 13.

Në fund të pjesës së tretë të vitit, ka pasur 125,974 raste kriminale dhe civile të cilat prisnin zgjidhje në gjyqet komunale dhe 11,924 raste kriminale dhe civile të cilat prisnin zgjidhje në gjyqet regjionale. Gjyqi suprem ka pasur 1,445 raste të pazgjidhura në sirtar në fund të pjesës së tretë të vitit.

Njësia për inspektime gjyqësore e UNMIK-ut ka monitoruar performancën gjyqësore dhe ka bërë rekomandime për disiplinën dhe trajnimet.

Këshilli Gjyqësor i përbashkët në mes të UNMIK-ut/IPVQ-të ka qenë përgjegjës për të shqyrtuar gabimet gjyqësore. Me 27 dhjetor Këshilli Gjyqësor i përbashkët ka pranuar 266 ankesa për gabime gjyqësore dhe të prokurorisë, duke përfshirë 10 aktakuza të akteve kriminale, 170 aktakuza të neglizhencës së funksioneve gjyqësore dhe të prokurorisë (95 për vonim të rasteve), 20 aktakuza për qëndrim jo-neutral, 6 ankesa në bazë etnike dhe 24 aktakuza për shkelje të kodit të etikës. Këshilli ka bërë një hulumtim për 159 rastet duke i mbyllur 147 dhe duke rekomanduar masa disiplinore për 12.

Derisa ligji ofron një panel prej dy ekspertëve dhe tre gjykatësve të mirren me raste të rënda, rregulloret e UNMIK-ut autorizojnë prokurorët ndërkombëtar për tu marr me rastet e natyrës politike dhe etnike, duke përfshirë një panel prej tre gjyqtarëve ndërkombëtar. Prej 250 rasteve nën prokurorët ndërkombëtarë gjatë shtatorit, gjykatësit ndërkombëtar i kanë zgjidhur 75 me një shkallë të lartë të dënimeve.

Procedurat Gjyqësore

Gjykimet janë publike, ligji i ofron të drejtën të akuzuarit të jetë prezent gjatë gjykimit, të përballet me dëshmitarët, të shoh dëshmitë, dhe të ketë përfaqësim legal, me shpenzime të gjyqit nëse është e nevojshme; megjithatë këto procedura shumë rrallë shfrytëzohen në praktikë. Të akuzuarit shihen si të pafajshëm përderisa gjyqësia nuk e dëshmon të

kundërtën dhe kanë të drejtë për ankesa. Gjykimet dëgjoen prej panelit të gjyqtarëve profesional por nuk ka juri të veçantë.

Ekspertët ligjor dhe vëzhguesit e të drejtave të njeriut vazhdojnë të shprehin brengën për mungesë të ndershmërisë në gjykimet kriminale duke përfshirë minoritetet të cilat raste ishin të udhëhequra prej personelit gjyqësor shqiptarë.

Pjesa e integritit gjyqësor e themeluar nga UNMIK-u vazhdoi të adresojë problemet e sistemit gjyqësor të cilat prekin minoritetet. Si shtesë, UNMIK-u operoi nëntë zyra ndërlidhëse gjyqësore katër prej të cilave janë formuar gjatë vitit që të asistojnë komunitetet minoritare në vendet me shumicë serbe duke i shoqëruar pjesëtarët e minoriteteve në gjyq, dorëzim të dokumenteve për ta, dhe duke i ofruar informacione dhe asistencë legale refugjatëve dhe personave të zhvendosur.

Sistemi hetues, gjyqësor dhe penal dhe Tribunali Ndërkombëtar për Krime të Luftës për ish-Jugosllavi ka vazhduar të identifikojë dhe të dënojë kriminelët për krime lufte prej konfliktit të 99-ës, megjithatë shumë raste kanë mbetur të pazgjidhura. Gjykimet kanë vazhduar të bëhen në gjyqe vendore për të arritur verdiktin për rreth 40 raste të akuzuara për krime lufte dhe gjenocid prej konfliktit të 99-ës. Për shembull, me 12 maj, gjyqi regional i Prishtinës ka gjetur fajtor tre prej pesë ish-luftëtarëve të UCK-së “Grupi i Kaçanikut” fajtor për krime lufte kundër civilëve në mes të 27 shkurtit dhe 21 marsit 1999 dhe i ka dënuar ata me tre deri në pesë vjet burgim, gjyqi i ka liruar dy të akuzuarit tjerë. Rasti i krimeve të luftës kundër komandantit të UCK, Selim Krasniqi është në paragjykim. Me 10 dhjetor, dëshmitari në këtë rast, Hasan Rrustemi, është plagosur dhe mbytur.

Të burgosurit politikë

Nuk ka raporte se KFOR-I, UNMIK-u ose IPVQ-të kanë mbajtur të burgosur politikë gjatë vitit.

Kthimi i pronës

HABITAT-i është përgjegjës për rikthimin e pronave të konfliktit të 99-ës. Në Mitrovicë, serbët e pjesës veriore të këtij qyteti kanë vazhduar të okupojnë pronat e shqiptarëve etnikë, derisa shqiptarët në pjesën jugore kanë vazhduar të okupojnë pronat e serbëve dhe nuk iu kanë lejuar qasjen në këto prona. Në fund të vitit HABITAT-i raportoi se është vendosur për 1,824 rastet në Mitrovicën Veriore, Leposaviq dhe Zveqan dhe për të gjitha 29 mijë rastet tjera. Në më shumë se gjysmën e këtyre rasteve HABITAT-I ka zgjedhur rastet duke i lejuar okupuesit të rijnë në ato vende me lejen e pronarit dhe me administrim të pronës nga HABITAT-i.

Më shumë se 17 raste të ndërlidhura me pronën janë të grumbulluara në gjyqet regionale, këto raste janë ekskluzivisht aktakuza materiale të serbëve për dëmet e shkaktuara gjatë luftës. OSBE-ja ka numëruar se rreth 11 mijë ankesa që kanë të bëjnë me pronën komerciale dhe agrikulturave janë duke pritur për tu zgjidhur.

f. Ndërhyrja arbitrare në familje, shtëpi, jetë private

Rregulloret e UNMIK-ut dhe korniza kushtetuese ndalojnë këto veprime, UNMIK-u, KFOR-i dhe IPVQ-ja ka respektuar këto ndalesa në praktikë, megjithatë KFOR-I ka asistuar policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në në kontrollime të pronave private të të dyshuarve dhe në mënyrë të pavarur ka kontrolluar pronat private pa urdhër gjyqi për armëmbajtje, duke u bazuar në Rezolutën 1244 të autoritetit paqeruajtës.

Pjesa 2: Respektimi i Lirisë Qytetare

a. Liria e Fjalës dhe Shtypit

Rregulloret e UNMIK-ut dhe korniza kushtetuese ofrojnë lirinë e shprehjes dhe të shtypit, dhe UNMIK-u, dhe KFOR-i në përgjithësi kanë respektuar këtë të drejtë në praktikë; megjithatë, ka pasur akuza se IPVQ ka ndërhyrë në lirinë e shprehjes dhe të shtypit sidomos me mediat të cilat kanë qenë kritik ndaj pozitave dhe performancës së tyre.

Individët mundën në përgjithësi të kritikojnë autoritetet në mënyrë publike ose private pa u dënuar.

Rregulloret e UNMIK-ut ndalojnë gjuhën e urrejtjes dhe gjuhën që nxit dhunë etnike, gjithashtu edhe artikuj në gazeta të cilat mund të inkurajojnë veprime kriminale ose dhunë.

111 stacionet e pavarura dhe të licencuara (89 radio dhe 22 stacione televizive) ishin aktive dhe shprehën një ndryshueshmëri të gjerë të pikëpamjeve. Autoritetet ndërkombëtare kontrolluan Radio Televizionin e Kosovës, një kompani Kosovare për transmetim publik. IPVQ-ja nuk kanë qenë pronarë të asnjë e as nuk kanë ushtruar kontroll ndaj tyre.

Zyra e komisionarit të përkohshëm për media ka implementuar rregullat e UNMIK-ut lidhur me mediat dhe ka fuqizuar kodi e veprimit për transmetim dhe media të shtypura. Si është planifikuar në kornizën kushtetuese më 21 prill Kuvendi i Komunës ka aprovuar me 11 korrik dhe përfaqësuesi special i KB-së ka pranuar ligjin në formimin e një komisioni të përhershëm të pavarur të mediave për të rregulluar transmetimin e mediave. Adaptimi i ligjit ka qar deri te një tranzicion i cili do të fillojë në shtator përgjatë të cilit zyra e komisionarit të përkohshëm do të shndërrohet në të përhershëm e mbikëqyrur nga këshilli drejtues shtatë anëtarësh.

Me 18 mars, përfaqësuesit e mediave e kanë adaptuar statutin e këshillit të shtypit për të ofruar një vetë-rregullim të mediave të shtypura. Zyra e përkohshme e komisionarit do të përfundojë së rregulluari mediat e shtypura në tetor.

IPVQ-ja kohë pas kohë ka ndërhyrë në media. Me 15 dhjetor, një stacion televiziv vendor ishte duke e mbuluar një storie lidhur me keqpërdorime materiale prej Enver Mujës, shefi i ekzekutivit të komunës së Gjilanit, i cili kishte ndërtuar një rrugë. Raportet e policisë raportuan se rojet e Mujës dhe dy shokë të tjerë kanë sulmuar tre reporterë televizivë duke e lënduar një dhe duke ia dëmtuar kamerën televizive. 13 gazetarë në Gjilan kanë dhënë dorëheqje duke akuzuar punëdhënësin e tyre se ka tentuar të ndalojë storien pas presionit prej komunës.

Gjatë vitit zyra e komisionarit të përkohshëm të mediave ka dënuar gazetën ditore “Bota Sot” me rreth 78 mijë \$ (65 mijë Euro) dhe gazetën *Pavarësia* me rreth 10,800 \$ (9 mijë Euro) e cila ka rezultuar në ndërprerje të botimit për shkeljet gjatë periudhës elektorale në shtator dhe tetor 2004.

Me 9 gusht, KPM ka dënuar gazetën serbe *Jedinstvo me* 13,200 \$ (11 mijë Euro) për publikimin e artikujve të pavërtetë kundër një grupi etnik dhe dështimin për të përmirësuar gabimin në kohë. Dënimi është zvogëluar më vonë në 8,400 \$ (7 mijë Euro). Me 3 qershor, persona të panjohur gjuajtën dhe plagosën për vdekje redaktorin e gazetës *Bota Sot*, Bardhyl Ajeti. Zyra e komisionarit të përkohshëm për media raportoi se sulmi është ardhur pas kontakteve të Ajetit me zyrën e komisionarit gjatë secilës Ajeti deklaroi se ai nuk pajtohet me pozitën redaktoriale të *Bota Sot* dhe ka vendosur të lë gazetën me anëtarët e stafit dhe të fillojë një publikim të ri. Hetimet e policisë lidhur me vrasjen kanë vazhduar.

Asociacioni i Gazetarëve Profesional të Kosovës ka raportuar se me 30 mars SHPKA-ja ka sulmuar fizikisht Behxhet Begu dhe Bardh Bekteshi prej RTK-së në Vushtrri për shkak të akuzës për parkim ilegal në pronën komunale. Një hetim i brendshëm i SHPK-së është duke vazhduar.

AGPK raportoi se me 19 tetor SHPK-a ka sulmuar dhe arrestuar gazetarët në një demonstratë prej anëtarëve të lëvizjes “Vetëvendosja”. Me 25 tetor një letër drejtuar përfaqësuesit special të Kombeve të Bashkuara nga avokati i popullit Marek Novicki ka thirrur për një hulumtim të pavarur të veprimeve të SHPK-së në incident duke akuzuar se SHPK-ja ka arrestuar dy gazetarë pasi që ata po fotografonin demonstratat dhe ka keqtrajtuar një. Disa dëshmitarë të rastit deklaruan se gazetarët ishin pjesëmarrës në demonstratë. Një hetim i brendshëm ka vazhduar gjatë vitit.

AGPK ka raportuar incidente të tjera të keqtrajtimit të mediave gjatë vitit. Në shkurt asociacioni ka akuzuar SHPK-në në bllokimin e xhirimit të presidentit serb Boris Tadic gjatë vizitës së tij në Kosovë . AGPK gjithashtu raportoi se persona të panjohur i kanë bërë kërcënime me vdekje përmes telefonit redaktorit *Top Ilira* në shkurt duke kërkuar që të ndalojë raportimin për Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Nuk ka pasur restriksione nga UNMIK-u, KFOR-I, IPVQ-të në Internet ose liri akademike.

b. Liria e Kuvendit Paqësorë dhe Asociacioneve

Liria e Kuvendit

Rregulloret e UNMIK-ut dhe korniza kushtetuese ofron lirinë e kuvendit dhe UNMIK-u, KFOR-i dhe IPVQ-të në përgjithësi kanë respektuar këtë praktikë.

UNMIK-u kërkoi nga organizatorët e demonstratave që të paralajmërojnë 48 orë më herët për koordinim të policisë. SHPK-ja dhe policia e UNMIK-ut rrallë kanë shfrytëzuar forcën që ti shpërndajnë demonstratat.

Me 19 tetor, anëtarët e SHPK-së me 19 tetor kanë sulmuar fizikisht demonstruesit duke arrestuar dhe dërguar në paraburgim për shkak të pjesëmarrjes në demonstratë në Prishtinë. (shih pjesën 1.c.).

Liria e Asociacioneve

Rregulloret e UNMIK-ut dhe korniza kushtetuese ofron lirinë e asociacioneve, dhe UNMIK-u, KFOR-i, dhe IPVQ-të respektojnë këtë të drejtë në praktikë. UNMIK-u në mënyrë rutinore ka regjistruar partitë politike dhe OJQ-të.

c. Liria e Religjionit

Rregulloret e UNMIK-ut dhe korniza kushtetuese ofrojnë lirinë e religjionit, UNMIK-u dhe IPVQ-ja në përgjithësi e kanë respektuar këtë të drejtë në praktikë.

Nuk ka rregullore specifike të licencimit të grupeve religjioze; megjithatë organizatat religjioze duhet të regjistrohen si OJQ me UNMIK-un dhe Ministrinë e Shërbimeve Publike në mënyrë që të blejnë pronë ose të pranojnë fonde prej UNMIK-ut dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Identiteti religjioz dhe etniciteti janë ngushtë të ndërlidhura. Serbët e identifikuar me Kishën Ortodokse Serbe e cila ka ndikuar në pikëpamjet kulturore, historike, politike dhe religjioze (shih pjesën e 5-të). Derisa shumica e komunitetit etnik shqiptarë kanë vazhduar ta shohin Kishën Ortodokse Serbe si simbol të nacionalizmit serb, relacionet në mes të liderëve të komunitetit etnik shqiptarë dhe Kishës Ortodokse Serbe janë përmirësuar lehtë gjatë vitit pas disa takimeve në mes të zyrtarëve të IPVQ-së dhe punëtorëve të kishës.

Në prill autoritetet e shkollave fillore e kanë larguar një nxënëse e cila ka qenë e mbuluar. Një rast tjetër i ngjashëm rezultoi në shprehje të mendimit në qershor 2004 nga avokati i popullit i financuar nga OSBE-ja se ndalimi i mbulimit duhet të aplikohet vetëm për mësues dhe zyrtarë, jo nxënës. Të dyja palët dorëzuan peticionet në Ministrinë e Arsimit dhe ankesë formale iu parashtrua avokatit të popullit, hetimet janë ende duke vazhduar.

Me 23 maj, mediat raportuan se një drejtor i shkollës publike e suspendoi një mësues që kishte vënë shall në kokë, duke cituar se ligji obligon institucionet publike arsimore të mbajnë një qëndrim neutral drejt religjionit. Me 29 maj, departamenti i arsimit në komunën e Prishtinës e largoi mësuesin nga puna.

Protestuesit gjithashtu raportuan disa raste ku autoritetet e shkollës kanë ftuar prindërit e nxënësve për ti mbajtur ata larg prej Protestantëve.

Komuniteti islam vazhdoi deklaratimet se UNMIK-u ka penguar radio frekuencat për një radiostacion Islam, mbyllja e dhomës së faljes në bibliotekën kombëtare, dhe refuzimi i komunës së Prishtinës që ti falet tokë publike për ndërtimin e një xhamie ishin shembuj të mungesës së lirisë së religjionit.

Protestantët raportuan diskriminim në qasje në media, sidomos prej RTK-së e cila ka mohuar kërkesën e komunitetit protestantë për transmetimin e tyre televiziv.

Keqtrajtimet shoqërore dhe diskriminimi

Sulmet e shqiptarëve etnik në Kishën Ortodokse Serbe dhe objektet tjera fetare gjatë trazirave të marsit 2004 kanë rezultuar në shkatërrim të gjerë të pronave, duke përfshirë shkatërrimin dhe dëmtimin e 30 vendeve religjioze, disa nga të cilat datojnë prej shekullit 14. Misioni i Këshillit të Evropës vlerësoi se do të duheshin rreth \$13.1 milion (9.7 milion Euro) për të rinovuar dhe riparuar vendet e dëmtuara. Demonstratat e kanë vonuar transferin e përgjegjësive për mbrojtjen e Kishave Ortodokse Serbe dhe simboleve tjera

fetare prej KFOR-it te UNMIK-u dhe SHPK-ja, megjithatë procesi i transferimit ka vazhduar për disa vende më të vogla religjioze.

Shqetësimet rreth sigurisë kanë parandaluar që priftë dhe motrat e nderit në disa manastire ortodokse serbe të shfrytëzohen disa pjesë të pronave të tyre, dhe familjet serbe kanë raportuar frikë gjatë udhëtimit Kosovë-Serbi për t'u bashkangjitur familjarëve në pushimet fetare dhe ceremonitë. Që të zvogëlojë shqetësimet lidhur me sigurinë, policia e UNMIK-ut ka dërguar rreth 350 policë në janar në 30 lokacione të zgjedhura për kthimin e serbëve të zhvendosur dhe të banuara me serbë. Bishopi Teodosije i Kishës Ortodokse Serbe deklaroi se me 31 dhjetor komuna e Gjakovës ka vendosur një monument të anëtarëve të UCK-së në tokën e cila ishte pronë e kishës.

Rreth 40 individëve prej dy familjeve në Prizren kanë prejardhje hebreje, por nuk ka sinagoga ose institucione hebreje. Nuk ka raporte të veprimeve anti-semitike.

Për një diskutim më detaj shih *2005 Raportin Ndërkombëtar të Religjionit*.

d. Liria e lëvizjes, Udhëtimi jashtë vendit, Kthimi nga diaspora

Rregulloret e UNMIK-ut dhe korniza kushtetuese ofron lirinë e lëvizjes megjithatë tensionet ndëretnike dhe shqetësimet reale dhe të perceptuara rreth sigurisë kanë penguar lirinë e lëvizjes. Gjatë vitit UNMIK-u, KFOR-I dhe IPVQ-të në përgjithësi kanë përmirësuar mbrojtjen e këtyre të drejtave për komunitetet minoritare.

Incidentet sporadike të dhunës dhe kërcënimeve drejtuar kundër minoriteteve kanë vazhduar të kufizojnë lirinë e lëvizjes për shqiptarët në Kosovën veriore. IPVQ-të dhe UNMIK-u kanë rritur përpjekjet për të lehtësuar udhëtimin e minoriteteve nëpër Kosovë, por rreziqet reale dhe të perceptuara i kanë ndaluar shumë pjesëtarë të minoriteteve që të udhëtojnë jashtë lagjes së tyre.

Për të zvogëluar rrezikun e sulmeve në mes të grupeve etnike serbe dhe shqiptare UNMIK-u ka vazhduar të ofrojë tabela regjistrimi pa pagesë për serben të cilët i kanë regjistruar veturat e tyre në Serbi.

Me 22 prill KFOR-i ka tërhequr veturat dhe barrikatat prej urës së Mitrovicës e cila lidh shumicën serbe në Mitrovicën veriore dhe shumicën shqiptare në Mitrovicën jugore. SHPK-ja ka marr kontrollin e urës me 6 qershor, me 18 korrik është hapur për gjithë trafikun civil për herë të parë pas vitit 1999-ës. Megjithatë shumë pak persona kanë vozitur me tabela Kosovare përgjatë urës si pasojë e frikës nga sulmet në Mitrovicën veriore.

Sipas rregulloreve të UNMIK-ut qendra e regjistrimit civil mund të lëshojë dokumente udhëtimi secilit do person i regjistruar si qytetarë i Kosovës, dhe qendra ka lëshuar dokumente të tilla. Me 3 tetor UNMIK-u transferoi përgjegjësitë menaxheriale dhe operative për qendrën e regjistrimit IPVQ-së por e mbajti autoritetin e përgjithshëm duke përfshirë lëshimin e dokumenteve të udhëtimit të UNMIK-ut dhe sigurinë bazës së të dhënave qendrore të regjistrimit.

Ligji ndalon The ligji ndalon emigrimin me forcë dhe autoritetet nuk e kanë shfrytëzuar atë.

Lëvizja e rregulluar e UNMIK-ut brenda dhe jashtë Kosovës

Personat e Zhvendosur

Duke u bazuar në zyrën e Komisionarit të Lartë për Refugjatë rreth 225,487 persona janë zhvendosur brenda Serbisë dhe Malit të Zi deri në fund të vitit prej konfliktit të 99-ës, përdërisa 1,364 prej 4,100 janë larguar nga shtëpitë e tyre në trazirat e marsit 2004, shumica prej Mitrovicës dhe Prishtinës mbeten ende të zhvendosur. Shumë pak të zhvendosur janë kthyer gjatë vitit si pasojë e pasigurisë për shkak të statusit të ardhshëm politik të Kosovës, mungesës së mundësive për punësim, shqetësimeve rreth sigurisë, dhe problemeve me pronë. Derisa disa organizata ndërkombëtare, OJQ dhe IPVQ-të kanë vazhduar të implementojnë projekte të vogla për kthim, vëzhguesit kanë kritikuar Ministrinë e porsaformuar të Komuniteteve dhe Kthimit për vonimin e fondeve për projektet e kthimit. Komunitatet kanë punësuar personel dhe kanë përgatitur strategji të kthimit pa rezultate konkrete.

UNHCR-ja ka raportuar se 2,048 minoritete janë kthyer në Kosovë gjatë vitit, duke përfshirë shqiptarët të cilët janë kthyer në vendet ku janë minoritete. Kthimi i përgjithshëm i minoriteteve prej 2000 –ës ka shkuar në 14,433. Një numër i vogël i serbëve janë kthyer krahasuar me 2004-shin ku më shumë Boshnjakë dhe Goranë janë kthyer. Serbët përbëjnë rreth 35% të të kthyerve gjatë vitit, krahasuar me 33 % në 2004. Romës (përfshirë Ashkalitë dhe Egjiptianët) kanë vazhduar të kthehen në numër pak më të madh, duke përbërë 45% të numrit të përgjithshëm të kthyer. Në Mitrovicë serbët në pjesën veriore të qytetit dhe shqiptarët në pjesën veriore kanë vazhduar të okupojnë pronën e njëri tjetrit, duke ngadalësuar kthimin e mundshëm.

Edhe pse IPVQ-të kanë rindërtuar më shumë se 95 % të shtëpive të dëmtuara dhe të shkatërruara në trazirat e marsit 2004 një numër i individëve të zhvendosur nga trazirat nuk janë kthyer për shkak të mungesës reale dhe të perceptuar të sigurisë, papunësisë dhe ankesave lidhur me kualitetin e rindërtimit. Numri i të kthyerve ka ndryshuar varësisht prej regionit dhe grupeve etnike.

Gjatë vitit UNMIK-u ka filluar të ndërtojë një objekt për të akomoduar rreth 531 Romë, Ashkali, dhe Egjiptianë të zhvendosur megjithatë të gjithë të zhvendosurit ende ndodhen në kampin e ndotur. Testimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë ka njoftuar për shtypje të lartë të gjakut për shumë nga banorët. UNMIK-u filloi një program të tillë për të ndërtuar një objekt për të zhvendosurit në Mitrovicën jugore të Romëve i cili ishte shkatërruar nga shqiptarët duke i akuzuar Romët për bashkëpunim me serbët por ende nuk është filluar. Me 2 shtator qendra e të drejtave Evropiane të romëve ka dorëzuar një ankesë në zyrën e prokurorit në Kosovë që të fillojë një hetim në këtë çështje, as një aktakuzë formale nuk është ngritur.

Mbrojtja e Refugjatëve

Ligji nuk jep mundësinë e azilit ose statusit të refugjatit në pajtim me Konventën e Kombeve të Bashkuara 1951 lidhur me Statusin e Refugjatëve dhe protokollin e tij 1967, megjithatë UNMIK-u iu ka dhënë statusin personave të zhvendosur si “persona me mbrojtje të përkohshme në Kosovë”. Në praktikë, UNMIK-u ka ofruar mbrojtje kundër kthimit të personave në shtetin ku ata frikohen nga ekzekutimi i tyre; megjithatë UNMIK-u nuk jep statusin e refugjatit ose azilin. UNMIK-u bashkëpunoi me Zyrën e Komisionarit të Lartë për Media dhe organizata tjera humanitare në asistimin e refugjatëve.

Pjesa 3; Respektimi i të drejtës politike: E drejta e qytetarëve për të ndërruar qeverinë e tyre

Rregulloret e UNMIK-ut dhe korniza kushtetuese ofrojnë qytetarët me të drejtën për të ndërruar qeverinë e tyre në mënyrë paqësore, dhe ata e kanë praktikuar këtë të drejtë në praktikë përmes zgjedhjeve periode dhe në përgjithësi të lira duke u bazuar në praktika universale.

Kosova ka vazhduar të jetë e administruar nën autoritetin civil të UNMIK-ut. UNMIK-u dhe administratori kanë themeluar një administrim civil ndërkombëtar në 1999 duke u bazuar në kampanjën ushtarake të Aleancës Veri-Atlantike e cila qoi deri te largimi i forcave serbe. Në 2001 UNMIK-u ka publikuar kornizën kushtetuese për IPVQ-të. Në kornizën kushtetuese, Kuvendi 120 anëtarësh i Kosovës zgjedh presidentin, kryeministrin, ministrat tjerë dhe zyrtarët e IPVQ-ve. Udhëheqësit Kosovarë kanë vazhduar ta kritikojnë UNMIK-t për një bartje të ngadalshme të kompetencave IPVQ-ve megjithatë misioni ndërkombëtarë ka mbajtur një numër të kompetencave duke përfshirë sigurinë dhe marrëdhëniet me qeveritë e huaja.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe vendorë kanë ardhur në përfundim se zgjedhjet e Kuvendit në tetor 2004 kanë qenë të lira dhe të ndershme, edhe pse më pak se 5% të serbëve kanë marrë pjesë për shkak të presionit nga qeveria serbe që të mos votojnë. Kosova ka një sistem shumë multi-partiak të dominuar prej katër partive shqipe me disa parti dhe koalicione minoritare.

Sipas rregulloreve të UNMIK-ut individët nominojnë vetën si kandidatë të partive të tyre, të cilët duhet të mbajnë zgjedhje interne të lira dhe të hapura në mënyrë që të zgjedhin listën e kandidatëve. Partia më e madhe LDK-ja ka injoruar këtë kërkesë gjatë konventës së partisë më 2004. Përcaktimi politik ka luajtur një rolë në qasjen ndaj shërbimeve qeveritare dhe mundësive sociale. Planifikimet tradicionale sociale dhe lojaliteti ndaj klaneve ka luajtur një rol të rëndësishëm në organizatat politike në mënyrë jo zyrtare.

Ka pasur raporte të sulmeve dhe kërcënimeve kundër personaliteteve politike dhe institucionale (shih pjesën 1.c.).

Janë 36 gra në Kuvendin me 120 karrige. Gratë duhet të kenë një të tretën të vendeve në secilën listë të kandidatëve partiak. Nuk ka gra në trupin drejtues 8 anëtarësh dhe vetëm një ministre. Gratë përfaqësojnë 28% të përfaqësuesve të zgjedhur komunal. Me 20 shtator, 34 anëtare të Kuvendit kanë themeluar një grup joformal të grave me personin e tetë në një bord multietnik.

Ka 21 pjesëtarë të minoriteteve në Kuvendin 120 anëtarësh duke përfshirë 10 serbë dhe 11 anëtarë të grupeve tjera duke përfshirë Turqit, Boshnjakët, Goranët, Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët. Dy ministra janë nga minoritetet njëri Serbë dhe tjetri Boshnjakë me tri zëvendësministra nga minoritetet. Një Boshnjakë dhe një Turk kanë pasur një vend në presidencën e Kuvendit, bojkoti i Serbëve ka lënë të zbrazët një ulëse. Gjatë vitit serbët në partinë më të madhe politike ka lënë vendet e zbrazëta dhe kanë vazhduar ta bojkotojnë Kuvendin, megjithatë anëtarët e partisë politike të Slavis Petkovic kanë zënë dy vende dhe kanë udhëhequr ministrinë. Korniza kushtetuese kërkon që Kuvendi të rezervon 10 ulës për serbët dhe për 10 anëtarë të grupeve tjera etnike, por minoritetet nuk të përfaqësuar sa duhet në nivelin komunal.

Korrupsioni qeveritar dhe Transparenca

Ka pasur një perceptim të gjerë se ka korrupsion në IPVQ dhe UNMIK. Ka pasur raporte të besueshme për parregullsitë duke përfshirë edhe tenderin e parë ndërkombëtar për telefoni mobile. UNMIK-u ka anuluar fituesin e zgjedhur nga IPVQ-të duke kërkuar që tenderi të shpallet për herë të dytë. Partia kryesore opozitare Partia Demokratike e Kosovës ka vazhduar të kritikojë qeverinë për korrupsion dhe ka prezantuar akuzat duke kërkuar nga UNMIK-u hetim, në fund të vitit hetim ka qenë në proces.

Me 2003 UNMIK-u ka publikuar ligjin për qasjen në dokumente zyrtare megjithatë ligji i ka përjashtuar dokumentet e UNMIK-ut dhe është përdorur shumë rrallë. Duke u bazuar në raportet e OSBE-së , IPVQ-të nuk kanë ofruar qasje publike ndaj dokumenteve gjatë vitit.

Pjesa e 4: Qëndrimi qeveritar ndaj hetimeve ndërkombëtare dhe joqeveritare kundër shkeljes së të drejtave të njeriut

Grupe të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore të të drejtave të njeriut në përgjithësi kanë punuar pa ndonjë restriksion duke hetuar dhe publikuar rezultatet në rastet e të drejtave të njeriut. UNMIK-u, KFOR-i dhe IPVQ-të në përgjithësi kanë bashkëpunuar dhe kanë shprehur pikëpamjet e tyre.

Një numër i madh i OJQ-ve vendore kanë marur fondet nga donatorët pas konfliktit të 99-ës, duke rezultuar në një shoqëri të shëndoshë të OJQ-ve kompetitive. OJQ-të vendore janë ankuar se fondet e donatorëve po zvogëlohen gjithnjë më shumë. OJQ-të religjioze janë ankuar lidhur me pamundësinë e përjashtimit prej taksave në disa gjëra të cilat importohen në Kosovë, ndërsa OJQ-të religjioze kanë raportuar diskriminim të bazuar në besim.

Organizata Ndërkombëtare për Migrim ka koordinuar trajnime dhe projekte për SHPK-në në bashkëpunim me OJQ-të tjera. Vëzhguesit e të drejtave të njeriut, duke përfshirë OSBE-në dhe disa OJQ vendore ishin aktive në dokumentimin e vrasjeve të motivuara politike dhe etnike, sulmeve dhe incidente të kërcënimeve.

Avokati i popullit i financiar nga OSBE-ja ka hulumtuar akuzat e shkeljes së ligjeve të të drejtave të njeriut nga qeveria. Derisa zyra e avokatit të popullit në mënyrë aktive ka lëshuar raporte dhe rekomandime, raportet e kësaj zyre rrallë janë përcjellur prej UNMIK-ut e sidomos prej policisë së saj. Shumë raste të hulumtuara prej zyrës kanë të bëjnë me të drejtat pronësore, keqpërdorimin e autoritetit zyrtar, veprimeve administrative ose gabimeve të autoriteteve publike, çështje që kanë të bëjnë me ndershmërinë dhe tejzgjatjen e proceseve gjyqësore, konfliktet e lidhura me punësimin dhe lirisë prej dënimit.

UNMIK-u, KFOR-i, dhe IPVQ-të në përgjithësi kanë bashkëpunuar me Tribunalin Ndërkombëtar për Krime të Luftës lidhur me krimet gjatë konfliktit të vitit 1999. Me 10 mars, Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë ka ngritur aktakuzën kundër kryeministrit të atëhershëm Ramush Haradinaj dhe të akuzuarve të tjera Idriz Balaj dhe Lah Brahimaj. Me 30 nëntor, Tribunali ka përfunduar gjykimin e Fatmir Limajt dhe dy shqiptarëve të tjerë Haradin Balaj dhe Isak Musliu i cili pat filluar në nëntor 2004. Në vendimin e tyre të

parë lidhur me konfliktin e Kosovës, tribunali ka dënuar Balajn me 13 vjet dhe ka liruar Limajt dhe Musliun.

Pjesa e 5: Diskriminimi, Keqtrajtimet Shoqërore dhe Trafikimi i Personave

Rregulloret e UNMIK-ut e ndalojnë diskriminimin të bazuar në racën, gjininë, prejardhjen etnike, aftësitë e kufizuara ose gjuhën, megjithatë dhuna dhe diskriminimi kundër grave, personave me aftësi të kufizuara dhe minoriteteve ka vazhduar.

Gratë

Dhuna familjare kundër grave, përfshirë keqtrajtimet bashkëshortore mbesin një problem serioz dhe i vazhdueshëm. Rregulloret e UNMIK-ut ndalojnë dhunën në familje dhe dënimet me burg janë prej 6 muaj e deri në 5 vjet burgim. Kur viktimat padisin në gjyq, SHPK-ja fillon hetimet dhe i sjell rastet në gjyq. Duke u bazuar në UNMIK-un, lojaliteti familjarë dhe komunitetet me lidhje të ngushta familjare dhe një numër i madh i grumbulluar i rasteve civile dhe kriminale ka rezultuar në një numër të vogël të rasteve të zgjidhura.

Qendra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Grave, një OJQ-vendore ka pranuar rreth 3,650 kërkesa për asistencë prej viktimave të dhunës gjatë vitit. Gjatë tetorit, avokuesit e viktimave nga UNMIK-u kanë qenë të përfshirë në 1,468 raste të dhunës familjare. Sistemi gjyqësor ka procesuar 77 urdhra të mbrojtjes prej janarit deri në tetor, autoritetet kanë arrestuar 341 persona duke rezultuar në hapjen e 1,045 rasteve.

Një total prej 52 nga 53 raste janë zgjidhur në tetor duke rezultuar në dënime prej vërejtjeve gjyqësore e deri te burgimi. Qëndrimet shoqërore tradicionale drejt grave në këtë shoqëri të dominuar nga meshkujt ka kontribuar në një nivel të lartë të dhunës dhe një numër të vogël të rasteve të raportuara.

Nuk ka agjensione qeveritare të cilat i dedikohen vetëm dhunës në familje. Katër qendra janë hapur për të asistuar viktimat e dhunës familjare dhe trafikimin, dy nga të cilat udhëhiqen prej OJQ-ve vendore dhe dy nga OJQ-të ndërkombëtare. SHPK-ja ka raportuar se 66 viktimat e dhunës familjare janë vendosur nëpër qendra banimi gjatë vitit. Disa OJQ vendore dhe ndërkombëtare kanë vazhduar aktivitetet për mbrojtjen e grave, megjithatë ato janë penguar prej traditës së qetësisë lidhur me dhunën familjare, keqtrajtimi seksual dhe dhunimit.

Gjatë vitit OSBE-ja, zyra e kryeministrit, UNMIK-u kanë hapur një numër telefoni për ti raportuar rastet e dhunës familjare. SHPK-ja gjithashtu ka ofruar kurse speciale në dhunën familjare dhe dhunimin në planprogramin e tyre.

Rregulloret e UNMIK-ut e konsiderojnë dhunimin si krim megjithatë dhunimi bashkëshortor nuk është adresuar në mënyrë të veçantë. Nën Ligjin Kosovar dhunimi dënohet me 1 deri në 10 vite burgim, kur dhunimi i personave të mitur (marrëdhënie seksuale me vajza nën 14 vjeç) dënohet me 1 deri në 5 vjet burgim.

Dhunimi nuk ka qenë i raportuar sa duhet për shkak të stigmatizmave kulturor lidhur me viktimat dhe familjet e tyre. Duke u bazuar në UNMIK-un avokuesit e viktimave iu kanë ofruar shërbime viktimave në rreth 30 raste të dhunimit. Deri në tetor gjyqi ka punuar në rreth 50 raste të dhunimit që kanë qar deri në 60 dënime, disa raste kanë pasur më shumë se një të akuzuar.

Ligji ndalon prostitucionin, por prostitucioni është prezent. Njësitë e policisë së UNMIK-ut për trafikim dhe prostitucion ka hetuar rastet e prostitucionit dhe të dyshuarit në

trafikim të njerëzve. Trafikimi i grave për qëllime të eksploatimit seksual është një problem serioz. (shih pjesën 5, Trafikimi).

Nuk ka ndonjë ligj specifik kundër abuzimit seksual i cili është një problem i shpeshtë. Vetëdijesimi shoqëror për abuzim seksual është i ulët, dhe shumë pak raste janë raportuar.

Gratë kanë të njëjtën të drejtë sikurse meshkujt, por meshkujt tradicionalisht nuk e kanë të njëjtin status social i cili ndikon në tretmanin e tyre brenda sistemit legal. Përkundër mungesës së barierrave legale, shumë pak gra kanë pozita udhëheqëse në biznese, SHPK ose qeveri. Derisa numri i grave të punësuar vazhdon të rritet papunësia ka mbetur e lartë rreth 70 % duke e krahasuar me 40 – 70 % të popullsisë në përgjithësi. Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj gruas kanë rezultuar në diskriminim. Në disa vende rurale, gratë shpesh kanë pasur pak mundësi për të marr vendime lidhur me fëmijët e tyre dhe të drejtën e tyre në pronë. Derisa gratë dhe burrat kanë të njëjtën të drejtë në trashëgim të pronës, prona e familjes sipas zakonit i përcillet meshkujve. Të vejat shqiptare sidomos në vende rurale janë të rrezikuara nga humbja e të drejtës për fëmijët e tyre për shkak të zakonit që fëmijët dhe prona ti përcillen familjes së burrit, derisa e veja duhet të kthehet në familjen e babait.

Në gusht zyra e kryeministrit ka formuar zyrën për barazi gjinore e cila ka filluar të koordinojë aktivitetet e barazisë gjinore në zyrën e UNMIK-ut për barazi gjinore. Gjatë vitit zyrës për barazi gjinore i janë përcjellur përgjegjësitë për rreth 26 zyrtarë shqiptarë për barazi gjinore dhe 4 zyrtarë serbë nën zyrën për qeverisje të mirë. Në tetor Kuvendi ka themeluar një nën-këshill funksional përt të Drejtat e Fëmijës, Barazi Gjinore, Peticione dhe Ankesa Publike.

Të luftojë diskriminimin kundër grave, UNMIK-u ka integruar anti-diskriminimin, anti-trafikimin dhe të drejtat e njeriut në planprogramin legal të Universitetit të Prishtinës gjatë vitit.

Fëmijët

UNMIK-u dhe IPVQ-të në përgjithësi i janë përkushtuar mirëqenies dhe të drejtave të fëmijëve.

Rregulloret e UNMIK-ut kërkojnë që fëmijët në mes të moshës 6 dhe 15 vjeçare duhet të regjistrohen në shkollë, megjithatë disa fëmijë nga minoritetet (duke u përjashtuar serbët) nuk kanë ndjekur shkollat e IPVQ-ve për shkak të shqetësimit rreth sigurisë. Arsimi primar është i lirë.

Duke u bazuar në UNICEF-in, 97.5 % të shqiptarëve dhe 99% të serbëve ndjekin shkollën fillore, derisa vetëm 77% nga mosha 7 deri në moshën 14 vjeçare prej komuniteteve jo serbe (Romë, Ashkali, Egjiptianë, Turq, Boshnjakë, Goranë dhe të tjerë) ndjekin shkollën. Fondi i KB për Fëmijët (UNICEF) raportoi më pas se 52% të fëmijëve të cilët kanë përfunduar shkollën fillore vazhdojnë në shkollën e mesme, 43% të tyre janë femra. Ka pasur numra më të vogël të ndjekjes së shkollës së mesme nga vajzat shqiptare se sa nga djemtë shqiptarë apo vajzat serbe. Disa fëmijë janë detyruar të lënë shkollën për të punuar (shih pjesën 6.d.).

Rregulloret e UNMIK-ut kërkojnë kushte për nxënësit dhe ofrojnë të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare deri në shkollë të mesme për minoritetet. Shkollat që japin mësim në

gj.Serbe, Boshnjake, Turke kanë funksionuar gjatë vitit. Të dyja palët fëmijët shqiptarë dhe serbë kanë ndjekur shkollat në kushte që nuk i kanë plotësuar as nevojat bazë. Pak shkolla kanë pasur fëmijët serbë dhe shqiptarë së bashku duke iu ofruar planprograme të tjera dhe duke e mbajtur mësimin me ndërrime.

Fëmijët Romët, Ashkalitë,dhe Egjiptianë kanë ndjekur shkollat e përziera me fëmijët shqiptarë por është raportuar të kenë qenë të kërcënuar në vendet me shumicë shqiptare. Fëmijët romë janë në disavantazh për shkak të varfërisë, e kjo ndikon që ata të fillojnë të punojnë në rrugë dhe në shtëpi në mënyrë që të kontribuojnë në të ardhurat e familjes. Disa fëmijë boshnjakë në vendet e banuara me boshnjakë kanë ndjekur shkollën në gj. Boshnjake por fëmijët jashtë këtyre zonave kanë ndjekur shkollën në gjuhën Shqipe. Qeveria ka ofruar kujdes shëndetësor dhe femrat dhe meshkujt kanë pasur qasje të barabartë në të.

Ka pasur raporte të abuzimit të fëmijëve, edhe pse nuk ka qenë gjerë i përhapur megjithatë papunësia e lartë dhe zhvendosja e familjeve ka rezultuar në shkallë të lartë të braktisjes së fëmijëve. Pasi që adoptimet dhe programet e familjes nuk kanë mundur të merren me të gjitha rastet autoritetet i kanë vendosur të porsalindurit dhe fëmijët në shtëpi grupe me pak persona për tu përkujdesur për ta. Pas përfundimit të luftës me 1999, prindërit kanë braktisur 500 fëmijë. Fëmijët me aftësi të kufizuara janë mbyllur me kujdes të pamjaftueshëm e sidomos në vendet rurale.

Gjatë vitit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka operuar me 32 qendra të mirëqenies sociale të cilët kanë asistuar 1,250 jetim, 1,075 fëmijë problematikë, 50 fëmijë të abuzuar, 68 fëmijë të braktisur, dhe 120 fëmijë me probleme në sjellje. Ministria ka menagjuar jetimoret dhe ka koordinuar me OJQ-të për ti vendosur ato në shtëpi banimi. Duke u bazuar në Qendrën për Punë Sociale, 19 fëmijë me aftësi të kufizuara të braktisur, prej moshës 3 – 18 vjeç jetojnë në shtëpi të financuara prej qeverisë nën kujdes 24 orësh dhe 15 prej tyre ndjekin shkollat speciale.

Martesat e fëmijëve kanë ndodhur sidomos te komunitetet Rome, Ashkali, Egjiptiane edhe pse UNMIK-u nuk ka mbledhur statistika për problemin.

Fëmijët janë trafikuar për qëllime të eksploatimit seksual. (shih pjesën 5, Trafikimi).

Puna e fëmijëve është një problem serioz (shih pjesën 6.d.).

Fëmijët dhe familjet e tyre janë ende të zhvendosur prej konfliktit të 99-ës.

Trafikimi i personave

Rregulloret e UNMIK-ut e konsiderojnë si krim trafikimin e personave megjithatë trafikimi i grave dhe fëmijëve mbetet një problem serioz. Ka pasur dëshmi të involvimit vendor dhe ndërkombëtar në trafikim.

Dënimi për trafikim është prej 2 deri në 20 vjet burgim. Marrja pjesë ose tentimi për të marr pjesë në trafikim dënohet me prej 2 deri në 20 vjet burgim ose deri në 15 vite nëse viktima është i mitur . Organizimi i një grupi për trafikim dënohet me 5 deri në 20 vjet burgim, duke bërë lehtësime për trafikimin përmes neglizhencës prej 6 muaj deri në 5 vjet burgim.

Një klient që ka marrëdhënie seksuale me një viktimë trafikimi mund të dënohet deri në 5 vjet, përderisa marrëdhëniet seksuale me një të mitur dënohet deri me 10 vjet burgim. Prostitucioni vullnetarë dënohet me dënime më të lehta, prostitutat mund të dënohen por

jo edhe klientët vetëm në rastet kur policia mund të vërtetojë se klienti ka ditur se ka pasur të bëjë me një viktimë trafikimi . Prostitucioni është bazë për deportim.

Gjatë vitit njësia e përbashkët kundër trafikimit e UNMIK-ut/SHPK-së kanë bërë 2,025 kontrole kafeterish, (25 prej të cilave ishin të fshehta), 60 hyrje me dhunë dhe 2,386 inspektive të cilat kanë rezultuar në mbylljen e 76 vendeve të cilat janë dyshuar për trafikim. UNMIK-u/SHPK-ja kanë arrestuar 92 persona për trafikimin e personave dhe kanë bërë edhe 32 arreste për trafikimin e viktimave duke rezultuar në 70 raste trafikimi të pranuar prej zyrës së prokurorit dhe 22 dënime. Në korrik 3 qytetarë shqiptarë janë dënuar për trafikim, prostitucion, dhunim dhe janë dënuar me burgim prej 10-12 vjet dhe klientët e përfshirë kanë qenë edhe zyrtarë të SHPK-së. Faktorët të cilët kontribuojnë në një numër të vogël të dënimeve përfshin rritjen e sofistikimit të krimit të organizuar që të shmanget lidhja direkt në mes të viktimave dhe kriminelëve kyç, si dhe mungesa e programit për mbrojtje të viktimave (edhe pse anonimiteti ofrohet gjatë gjyqimit përmes dëshimit me shkrim) trajnime jo-adekuate të personelit gjyqësor dhe dështimi i policisë për të adaptuar teknika të reja të cilat përdoren prej trafikuesve.

UNMIK-u dhe SHPK-ja, Policia kufitare, OSBE-ja, Zyra për Qeverisje të Mirë, Ministria e Shëndetësisë, Arsimit , Shërbimeve Publike, Punës dhe Mirëqenies Sociale janë përgjegjëse për luftimin e trafikimit. Plani i veprimit të IPVQ-ve për luftimin e trafikimit është lëshuar në maj me qëllim të konsolidimit të përpjekjeve qeveritare për të luftuar trafikimin.

Kosova është burim, transit dhe pikë destinimi për personat e trafikuar. Trafikimi i brendshëm është një problem në rritje. Sikurse dhe vitet e kaluara, shumica e viktimave ishin femra dhe fëmijë të trafikuar prej Evropës Lindore, Ballkanit, Bashkimit Sovjetik në Kosovë në mënyrë primare për eksploatim seksual por edhe për shërbim ose punë me forcë në bare dhe restorante dhe prej Kosovës në Maqedoni, Shqipëri, dhe Evropë Perëndimore. Gjatë vitit 30 prej 55 viktimave të trafikuar janë kthyer në komunitetin e tyre.

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve ka asistuar 59 viktima të trafikuar gjatë vitit, 52 prej të cilave ishin femra, 41 të mitur, 50 banorë, 46 ishin shqiptarë. Duke u bazuar në IOM-in për viktimat që vijnë jashtë Kosovës prej 2000 më shumë se 45 % ishin prej Moldavisë, 19 % prej Rumanisë, 12% prej Ukrainës dhe pjesa tjetër prej Bullgarisë, Rusisë, Shqipërisë, Serbisë, Malit të Zi, Sllovakisë dhe Nigerisë. Shumica e viktimave ishin në mes të moshës 18 deri në 24 vjeçare. Shënimet e IOM-it kanë specifikuar se 64% të viktimave Kosovë janë trafikuar brenda, derisa 15% janë trafikuar në Maqedoni dhe 13% në Shqipëri dhe Itali. IOM-i ka asistuar 19 viktima – të gjitha të mitura gjatë vitit ku 8 prej tyre ishin Kosovare.

Numri i përgjithshëm i rasteve të trafikimit që përfshijnë të miturit është rritur prej 2004-ës. Fëmijët dhe vajzat e reja prej vendeve rurale ishin në rrezik të të qenit të trafikuar, sikurse ishin edhe vendet urbane me shkallë të lartë të varfërisë, papunësisë dhe analfabetizmit. IOM-i raportoi se 73% të Kosovarëve të cilët kanë qenë të trafikuar kanë kryer vetëm shkollën fillore.

Trafikimi i viktimave ka funksionuar në industrinë e seksit, sidomos në bordele dhe klube të natës por duke u rritur edhe në rezidenca private. Më pak se 20% raportuan se ishin të vetëdijshëm se do të punojnë në atë industri kur i kanë lënë shtëpitë e tyre. Trafikimi i viktimave ka raportuar se ato ishin të ekspozuara ndaj rrahjeve, dhunimit, mohimit të qasjes së kujdesit shëndetësor, dhe konfiskimit të dokumenteve të

identifikimit dhe udhëtimit. Viktimat shpesh janë gjetur në kushte të këqija shëndetësore dhe psikologjike.

UNMIK-u raportoi se trafikuesit shpesh kanë punuar si pjesë e përpjekjeve të koordinuara të krimit të organizuar në mes të serbëve dhe shqiptarëve, me Serbinë dhe Malin e Zi duke shërbyer si një qendër për trafikimin e viktimave prej Evropës Lindore në dhe përmes Kosovës. Pronarët e bareve dhe bordeleve kanë blerë viktimat prej rrjetave të organizuara të krimeve.

Metodat e trafikimit janë sofistikuar. Si reagim ndaj kampanjës agresive prej njësisë anit-trafikuese të UNMIK-ut, trafikuesit kanë larguar aktivitetet e tyre prej bareve dhe klubeve në shtëpi private, ku operacionet ishin shumë vështirë të zbulohen. Trafikantët kanë rritur pagesat e tyre në mënyrë që të inkurajojnë viktimat që të refuzojnë asistencën. IOM-i raportoi se prej 476 viktimave ndërkombëtare të cilat i ka asistuar prej 2000 –ës, 40% ka thënë se kanë rënë pre duke iu ofruar punë, 30% deklarojnë se kanë qenë të kidnapuar, 17 % i janë premtuar martesë. Në 83% të rasteve , rekrutimi ka qenë përmes kontakteve personale, rekrutuesi ka qenë i njohur i viktimës në 45% të rasteve, shoqëria ose shoku i familjes në 10% të rasteve. Rekrutuesit në të shumtën e rasteve ishin femra.

Ka pasur dëshmi anekdotale gjatë vitit se disa punëtorë UNMIK-ut dhe IPVQ-ve kanë injoruar trafikimin dhe se një numër marrëdhëniesh financiare dhe rrjeta kanë ekzistuar në mes të udhëheqësve politik dhe rrjeteve të krimit të organizuar të cilët kanë pasur interes financiar në trafikim. Si shtesë, disa prokurorë vendorë kanë raportuar raste ku i njëjti avokatë ka përfaqësuar trafikuesin dhe viktimat.

Gjatë vitit zyrtari i UNCHR-së Rasheed Khoon është gjykuar para një gjyqtari ndërkombëtar për marrëdhënie seksuale me femra të mitura dhe iu ka ofruar narkotikë të miturve të tjerë në mes të shtatorit dhe dhjetorit 2004. Me 2 nëntor, Khoon është dënuar me 3 vjet burgim për abuzimin e personit nën 16 vjeç dhe falsifikimin e dokumenteve zyrtare. Një femër shqiptare e cila ishte bashkëpunëtore u dënua me 2 vjet burgim.

Derisa rregulloret e UNMIK-ut ofrojnë një mbrojtje për viktimat e trafikuar kundër akuzave kriminale për prostitucion dhe kalim ilegal të kufirit , disa gjyqtarë vendor gabimisht i dërgojnë viktimat e trafikuar në burg. Disa gjyqtarë vendor gjithashtu gabimisht kanë lëshuar urdhra deportimi kundër grave të dënuara për prostitucion si pasojë e mungesës së dokumenteve megjithatë UNMIK-u nuk i ka fuqizuar urdhrat e tillë. Tabu kulturore dhe rreziku prej diskriminimit social ka shkaktuar që shumica e viktimave Kosovare të heshtin për përvojat e tyre.

OJQ-të ndërkombëtare dhe vendore ishin burim kyçë i trafikimit të viktimave. OJQ-të lokale si Këshilli Metodist i Bashkuar dhe Qendra për Mbrojtje të Grave dhe Fëmijëve ka operuar qendra banimi të cilat kanë ofruar kujdes mjekësor dhe psikologjik për viktimat e trafikimit në bashkëpunim me UNMIK-un, OSBE-në, dhe IOM-in.

Një objekt i brendshëm i sigurisë ka ofruar qendra banimi për viktimat derisa kanë vendosur nëse duan ta lën vendin apo të dëshmojnë kundër trafikuesve. Policia shpesh i ka referuar viktimat e trafikimit IOM-it përmes zyrave regjionale të OSBE-së .

IPVQ-të janë përfshirë në trajtimin e viktimave të trafikimit në janar kur Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me UNMIK-un dhe OSBE-në kanë hapur një njësi gjysmë të pavarur ku ishin vendosur të miturit të cilët ishin viktimat të trafikimit, abuzimit, dhe dhunës në familje. Pesë të rinj kanë marrë dhoma, arsimim , trajnim në punë në objekt.

Organizatat ndërkombëtare sidomos IOM-i dhe OJQ-të kanë organizuar kampanja parandaluese në parandalimin e trafikimit. Në korrik IOM-i ka filluar një kampanjë 12 mujore për të rritur vetëdijesimin publik lidhur me këtë problem. Zyra e kryeministrit për qeverisje të mirë, Ministria e Arsimit dhe IOM-i kanë shpërndarë materiale edukative kundër trafikimit për shfrytëzim në shkolla fillore dhe të mesme. Në shtator zyra për qeverisje të mirë ka filluar një kampanjë publike drejtuar klientëve potencialë të prostitutave të cilat ishin viktime të trafikimit.

Personat me aftësi të kufizuara

Rregulloret e UNMIK-ut ndalojnë diskriminimin kundër personave me aftësi të kufizuara në punësim, edukim, qasje në kujdes shëndetësor, dhe në shërbimet e tjera shtetërore megjithatë ka pasur diskriminim në praktikë. Ligji nuk ka përmbushur standardet ndërkombëtare dhe nuk ka pasur ekspertizë në çështjet e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Nuk ka ligje për përkujdesje dhe me proceset e përshtatshme të mbrojtjes, ligji nuk njeh vendosjen e individëve me aftësi të kufizuara mentale në institucione dhe tretmanin jo të vullnetshëm si çështje legale. Ligji mandaton qasjen në ndërtesa zyrtare megjithatë nuk është fuqizuar në praktikë.

Duke u bazuar në OJQ-në ndërkombëtare “Të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore” pacientët me aftësi të kufizuara mendore kanë vazhduar të mbahen të mbyllur në kushte të izoluara pa bazë ligjore, pasi që nuk ka ligj i cili rregullon procesin e dërgimit të personave në psikiatri ose në objekte për kujdes social ose nuk mbron të drejtat brenda institucioneve. Në disa individët me nevojë për tretman shëndetësor mendor janë dënuar për krime të vogla dhe janë dërguar në burgje të cilat nuk kanë ofruar tretman adekuate.

Në fund të vitit as UNMIK-u e as IPVQ-të nuk ngritën aktakuza ose nuk morën veprime legale si përgjigje ndaj raportit të MDRI-it i cili gjeti dëshmi të dhunës fizike, keqtrajtme seksuale, neglizhencë dhe paraburgime arbitrare prej personelit dhe pacientëve në objektet e shëndetit mendor në Institutin e Shtimes, në Shtëpinë e Pleqve dhe në Qendrën Universitare të Prishtinës.

Ministria e Arsimit, Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale, Shërbimeve Publike ishin përgjegjës për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.

Ka rreth 14 mijë persona me aftësi të kufizuara mendore. Si përgjigje ndaj raportit të MDRI-it në dhjetor 2004 që përkujdesja institucionale e personave me aftësi të kufizuara i ka lënë të izoluar, të mbyllur dhe të ndjeshëm ndaj dhunës fizike dhe abuzimit seksual, IPVQ-të zgjeruan mundësitë për banime të pavarura për persona të tillë dhe shpenzuan në vend të \$144 mijëve \$240 mijë (120 mijë deri në 200 mije Euro) secili në 14 dhoma integrimi të aprovuara nga MDRI. . UNMIK-u raportoi Ministria e Shëndetësisë kanë marr hapa gjatë vitit për të zhvilluar udhëzime administrative për institucionet e shëndetit mendor të cilat rezultojnë në transferim korrekt të të burgosurve me aftësi të kufizuara mendore deri te klinikat shëndetësore. KLMDNJ raportoi se të burgosurit me aftësi të kufizuara mendore shpesh janë mbajtur në burgje për shkak të mungesës së tretmanit mjekësor.

Minoritet Kombëtare/Racore dhe Etnike

Diskriminimi zyrtar dhe shoqëror lidhur me punësimin, shërbimet sociale, shfrytëzimin e gjuhës, lëvizjen e lirë, të drejtës për tu kthyer, dhe të drejtave të tjera bazë si dhe

keqtrajtimi i pjesëtarëve të minoriteteve janë përmirësuar përgjatë viteve, edhe pse diskriminimi ka vazhduar sidomos kundër serbëve, romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Dhuna dhe krimet kundër pronave të minoriteteve janë zvogëluar por prapë janë problem. Policia e UNMIK-ut raportoi rreth 184 krime të motivuara në baza etnike përgjatë pjesës së tretë të vitit. Megjithatë, duke u bazuar në UNMIK-un, incidentet kundër minoriteteve nuk janë raportuar sa duhet si pasojë e mosbesimit në SHPK dhe sistemin ligjor. Në gjysmën e parë të vitit, OJQ-të kanë pasur dëshmi për rreth 6 rasteve në javë si: gjuajtjes me gurë, sulmeve fizike, dhe keqtrajtimit të serbëve të Kosovës dhe minoriteteve tjera, si dhe krimet kundër pronës si: djegien dhe vandalizmin.

Gjatë vitit policia dhe KFOR-i ndërmorën një operacion të gjerë për ti gjetur personat përgjegjës për trazirat ndëretnike të marsit 2004 të cilat rezultuan në vdekjen e 8 serbëve dhe 12 shqiptarëve, lëndimin e më shumë se 900 personave, dëmtime të rënda dhe shkatërrime të më shumë se 900 shtëpi të serbëve, romëve, ashkalive dhe 30 Kisha Ortodokse dhe manastire.

Në raportin e korrikut në përcjelljen e veprimeve pas trazirave UNMIK-u deklaroi se 348 individë janë sjellur para gjyqit për aktakuza lidhur me trazirat. Prej këtyre 179 raste janë kryer, 71 presin gjykimin dhe 98 janë nën hetime. Së paku 57 raste serioze janë udhëhequr prej avokatëve ndërkombëtarë dhe kanë rezultuar në burgime deri në 16 vjet burg. Gjyqtarët e Kosovës kanë përcjellur më shumë se 85 dënime duke filluar me dënime të lehta, vërejtje nga gjyqi, dënime deri në \$240 (200 Euro) e deri në burgim prej 2 muaj deri në 2 vjet. Me 19 maj, paneli ndërkombëtar i gjyqtarëve në Gjilan ka dënuar gjashtë shqiptarë me lidhshmërinë me mbytjen e dy serbëve dhe i ka dënuar ata prej 3.5 deri në 16 vjet burgim.

Prej shtatë personave të dyshuar për organizimin dhe udhëheqjen e trazirave, hetimet kriminale janë duke u zhvilluar për katër prej tyre.: Komandanti rezervë TMK, Naser Shatri; zëdhënësi i veteranëve të luftës së UCK-së në Pejë, Nexhmi Lajci; zëdhënësi i asociacionit të veteranëve të luftës në Gjilan, Shaqir Shaqiri; dhe zëdhënësi i asociacionit të veteranëve të luftës në Vushtrri, Salih Salihu.

Në fund të vitit IPVQ-të kanë rindërtuar më shumë se 95 të shtëpive të dëmtuara ose shkatërruara në mars 200 dhe kanë filluar rindërtimin e kishave. (shih pjesën 2.c.).

Shqiptarët shkatërruan djegën prona private të cilat iu takonin serbëve, disa raste të dhunës kundër serbëve mund të kenë qenë përpjekje për të detyruar ata ti shesin shtëpitë. Një rregullore e UNMIK-ut parandalon shitblerjen e shumë komuniteteve serb në përpjekje që të parandalojë kërcënimet ndaj pronarëve të pronave minoritare në disa vende megjithatë rrallë është fuqizuar. Avokati i popullit dhe grupet për të drejtat e njeriut kritikojnë rregulloret si limitim i aftësisë së serbëve për të ushtruar të drejtat e tyre pronësore.

Diskriminimi vazhdoi kundër serbëve në fushën e arsimit dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor prej IPVQ-ve. Punësimi i minoriteteve në IPVQ-të ka vazhduar të jetë i ultë dhe është kufizuar në nivelet më të ulëta të qeverisë. Pjesëtarët e minoriteteve kanë zënë 11% të posteve në ministrinë e IPVQ-ve pavarësisht prej objektivave për 16 %.

Autoritetet nuk kanë përparuar gjatë vitit në hetimin dhe dënimin 2003 raste të dhunës kundër serbëve. Romët jetojnë në varfëri të plotë dhe ata të cilët kanë jetuar në Mitrovicë janë parë si bashkëpunëtorë të serbëve prej shqiptarëve dhe si rezultat shtëpitë e tyre janë shkatërruar dhe ata janë detyruar të jetojnë në kame ku ende ndodhen.

Romët nëpër Kosovë kanë qenë objekt i diskriminimit të vazhdueshëm social dhe ekonomik dhe nuk kanë pasur qasje në higjienë bazike, kujdes shëndetësor dhe edukim dhe ishin shumë të varur nga ndihmat humanitare. Edhe pse janë bërë disa përpjekje për të rivendosur Romët, Ashkalitë, dhe Egjiptianët në shtëpitë e tyre të cilat kanë jetuar para se të fillojë konflikti i 1999-ës në Vushtrri shqetësimet e sigurisë kanë mbetur.

Udhëheqësit boshnjakë kanë vazhduar të ankohen se mijëra anëtarë të komunitetit të tyre e kanë lënë Kosovën për shkak të diskriminimit dhe mungesës së mundësive ekonomike.

Në shtator autoritetet filluan procesin e reformës së qeverisë vendore (decentralizimin) me hapjen e pilot projekteve në Hani të Elezit (Shqiptarë), Mamushe (Turq), dhe Junik (Shqiptarë). Procesi është vonuar sepse partitë opozitare kanë vazhduar ta kundërshtojnë programin e punës të qeverisë, qeveria punon ngadalë, dhe serbët kanë lënë diskutimet si pasojë e paaftësisë për të arritur një konsensus në kufijtë për dy pilot projekte të serbëve në Gjilan dhe Gracanicë.

Abuzimet tjera shoqërore dhe diskriminimi

Ligji ndalon diskriminimin e bazuar në orientim seksual megjithatë ky ligj nuk është aplikuar gjatë vitit.

Qëndrimet tradicionale shoqërore lidhur me homoseksualitetin kanë kërcënuar shumë homoseksualë duke e mshehur orientimin e tyre seksual . Homoseksualët janë ndier të pasigurt me shumë kërcënime ndaj sigurisë së tyre personale. Mediat e shtypura më parë kanë fuqizuar këto qëndrime duke publikuar artikuj negativ lidhur me homoseksualitetin i cili i ka karakterizuar ata si të sëmurë mendor dhe si të aftë në abuzimin e fëmijëve. Homoseksualët gjithashtu raportuan diskriminim në punë. Së paku një parti politike Partia e drejtësisë e orientuar nga Islami ka përfshirë censurimin e homoseksualitetit si një reformë politike. Me 31 dhjetor mediat lokale raportuan se zyrtarët e SHPK-së kanë sulmuar verbalisht At dhe keqtrajtuar dy të rinj pasi që ishin sulmuar me thikë. SHPK-a ka suspenduar dy policët pa pagesë duke pritur hetimin.

Pjesa 6 Të drejtat e punëtorëve

a. E drejta e asociacioneve

Rregulloret e UNMIK-ut i lejojnë punëtorët të formojnë dhe ti bashkohen sindikatave pa autorizim ose pa kërkesa të tepërta, dhe punëtorët e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë në praktikë.

E vetmja sindikatë e njohur si Bashkësia e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka deklaruar më shumë se 120 mijë anëtarë; vetëm 50 mijë anëtarë (rreth 10 përqind të forcës punëtore) kanë qenë të punësuar. Rregulloret e UNMIK-ut ndalojnë diskriminimin e sindikatave, megjithatë disa zyrtarë të sindikatave kanë raportuar diskriminimin në praktikë. BSPK ka raportuar që vetëm një numër i vogël i kompanive kanë respektuar rregulloret që parandalojnë diskriminimin kundër sindikatave dhe kanë deklaruar se të drejtat e punëtorëve janë shkelur në secilin sektor, duke përfshirë organizata ndërkombëtare ku personeli nuk ka pasur sigurim ose pension.

b. E drejta për tu organizuar dhe për kontratë kolektive

Rregulloret e UNMIK-ut lejojnë sindikatat ti kryejnë aktivitetet e tyre pa ndërhyrje dhe UNMIK-u e ka mbrojtur këtë të drejtë në praktikë. Rregulloret e UNMIK-ut gjithashtu ofrojnë të drejtën për tu organizuar dhe kontratë kolektive pa ndërhyrje, dhe qeveria nuk e ka ndaluar këtë të drejtë në praktikë; megjithatë kontrata kolektive është realizuar vetëm në një rast. Rregulloret e UNMIK-ut nuk njohin të drejtën për të protestuar, protestat nuk u ndaluan në praktikë dhe kanë ndodhur gjatë vitit. Nuk ka pasur zonë të procesimit të eksportit.

c. Ndalimi i punës me dhunë dhe të obliguar

Rregulloret e UNMIK-ut ndalojnë punën obligative dhe me dhunë, duke përfshirë fëmijët, megjithatë ka pasur raporte se këto kanë praktika kanë ndodhur në praktikë (shih pjesën e 5 dhe 6).

d. Ndalimi i Punës së Fëmijëve dhe Moshë minimale për punësim

Rregulloret dhe politikat e UNMIK-ut ndalojnë eksplotimin e fëmijëve në vendet e punës, duke përfshirë ndalimin e punës obligative ose me forcë për fëmijët, duke ofruar kushte të përshtatshme pune, megjithatë UNMIK-u dhe IPVQ-të rrallë i kanë sfiduar këto praktika edhe nëse kanë ndodhur.

Ligjet e punës para vitit 1989 të cilat janë në fuqi si moshë minimale për punësim e marrin moshën 16 vjeçare dhe në moshën 18 mund të punojnë çfarëdo edhe ato të cilat rrezikojnë shëndetin, sigurinë, moralin e të rinjve por ndalojnë punën e fëmijëve në moshën 15 vjeçare, përveç atëherë kur nuk pengon ndjekjen e shkollës.

Në fshatra dhe në ferma, të rinjtë zakonisht punojnë që ti ndihmojnë familjet e tyre. Fëmijët e qyteteve punojnë punë të ndryshme si në autolarje, shitje të gazetave, duhanit dhe kartelave të telefonit në rrugë numri i fëmijëve të tillë është rritur vitin e fundit, edhe pse statistikat nuk janë mbajtur prej UNMIK-ut apo IPVQ-së. Disa fëmijë kanë bërë edhe punë fizike si bartja e mallrave të ndryshme.

Trafikimi i fëmijëve ka qenë një problem serioz gjatë vitit sidomos është bërë për keqtrajtme seksuale (shih pjesën e 5-të).

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me UNMIK-un ka koordinuar politikat për mbrojtjen e fëmijëve, dhe departamenti i Ministrisë për Mirëqenie Sociale ka pasur përgjegjësinë që të sigurojë mbrojtjen e fëmijëve megjithatë ministria nuk ka bërë inspektime e as nuk ka fuqizuar ligjet e punës së fëmijëve gjatë vitit.

e. Kushtet e pranuar të punës

Edhe pse rregulloret e UNMIK-ut duhet të ofrojnë një rrogë minimale, ende nuk është adaptuar një gjë e tillë. Derisa shumë prej organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-të paguajnë paga adekuate, mesatarja e pagave në sektorin publik me orar të plotë është 181 \$ (151 Euro) dhe mesatarja e pagave në sektorin privat është 250 \$ (208 euros) shuma të cilat janë jo të mjaftueshme për të bërë një jetë normale për punëtorin dhe familjen e tij.

Rregulloret e UNMIK-ut përfshijnë një orar me 40 orë pune, kërkojnë pauzë për pushim, kufizojnë numri e orëve jashtë orarit deri në 20 për javë dhe 40 orë për muaj, kërkojnë pagesën më të madhe për punën jashtë orarit, dhe ndalojnë punën e tepruar jashtë orarit. Inspektorati i punës brenda Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies sociale është përgjegjëse për fuqizimin e standardeve të punës. Inspektorati ka këshilluar punëdhënësit dhe ka dënuar vetëm një punëdhënës gjatë vitit për shkeljen e standardeve. Punëdhënësit zakonisht dështojnë në implementimin e këtyre rregulloreve për shkak të shkallës së lartë të papunësisë në Kosovë.

Inspektorati i punës ka qenë përgjegjës për fuqizimin e standardeve shëndetësore dhe të sigurisë por nuk ka pasur personel të trajnuar dhe nuk e ka bërë punën në mënyrë efektive. Ligji nuk lejon punëtorët të largohen nga vendet e rrezikshme të punës pa u siguruar që nuk e kanë rrezikuar punën e vazhdueshme të tyre.

Raporti i plotë në gjuhën angleze mund të gjendet në adresën:
<http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2005/61673.htm>